



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL NR. 4

Rrogozhinë, më 28.04.2025 ora 12 : 00⁰⁰

Zhvillohet mbledhja e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën Nr.1594.Prot datë 18.04.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.03.2025.
- 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Shqyrtim i informacionit, “Mbi rendin dhe sigurinë publike në Bashkinë Rrogozhinë”, të ardhur nga Komisariati i Policisë Kavajë.
- 7- Shqyrtim i Raportit, “Mbi masat e marra për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përgatitjen e sezonit turistik në Bashkinë Rrogozhinë”, të ardhur nga drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
- 8- Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë.
- 9- Të ndryshme.
 - *Kërkesë nga z. U. Barmeta për ndihmë financiare për shkak të dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në fermën e tij.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Mitat Daja, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Silvana Aliu, Mukades Gixhari.



Mungojnë :

Hekuran Xhani, Indrit Dedej, Lije Dedej, Isa Halili, Sokol Gosa, Lorena Baku, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Qerim Saliu - Përfaqësues i Policisë së Shtetit, stacioni policisë Rrogozhinë.
11. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
12. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : 11 Këshilltarë, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm për mbledhje e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Erind Tosku, znj. Fatmira Thartori, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, z. Mitat Daja, znj. Besnike Coraj, znj. Merilin Saraçi, z. Saimir Cani, znj. Silvana Aliu dhe Mukades Gixhari. Jemi 11-gjithsej.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës



20.03.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 8 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 9 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .10. Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë.

-Kemi dhe Vendimin e fundit që është marrë në këtë mbledhje, i cili i është përcjellë Prefektit për verifikim ligjshmërie dhe Prefekti shprehet Vendimi nr.11, datë 20.03.2025 “Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi “Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025”, nuk është akt me karakter normativ. Pra është akt me karakter individual dhe i cili dhe ky hyn në në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar.

Para se të kalojmë në rendin e ditës ju kam dërguar në grupin e WhatsApp një projekt vendim shtesë “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim dhe ta shqyrtojmë në pikën të ndryshme? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

Tani kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 2, Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.03.2025. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kemi pikën 3.

Enver Memolla . Kryetare më fal të ndërhyj pak.

Mukades Gixhari . Po, tek miratimi i rendit të ditës pika një?

Enver Memolla . Jo, tek miratimi i rendit të ditës jemi jashtë programit të këshillit bashkiak për konsultimin e buxhetit nuk ka ardhur fare këtë radhë . Mos ta lejojmë këtë sepse do ndodhë



Dhjetori i 2024 prap dhe me atë që na thanë Bashkitë e Forta nuk është gjë e mirë. Kështu që të vejmë në lëvizje që atë pjesë të na e dërgojnë.

Mukades Gixhari . Po, do të ja dërgojmë administratës.

Enver Memolla . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit ju. Kemi pikën 3, Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili. Atëherë...

Alime Hoxha . Jo, ajo nuk mund të shtyhet ajo do hidhet në votim.

Silvana Aliu . Jo përderisa pranuat që mbledhja do bëhet në këto kushte, meqë kryetarja na tha do shtyhet, besoj se po.

Mukades Gixhari . Po pra, do e lexoj dhe do e kthejmë ...

Mitat Daja . Shtyhet kjo do shtyhet.

Enver Memolla . Një sekondë, miratimi i rendit të ditës u miratua pa ndryshime.

Mitat Daja . Mirë më do çohemi e do ikim.

Enver Memolla . Jo s'më kuptove mund ta kishim bërë me ndryshime këtë po them.

Mukades Gixhari . Kryetarja erdhi dhe na kërkoi çfarë mund të shtyjme dhe çfarë jo.

Enver Memolla . Mirë pra këtë po them se unë kështu e dija.

Mitat Daja . E shtyjme për herë tjetër.

Alime Hoxha . Po pra po por e kemi shtyrë shumë dhe jemi jashtë çdo lloj afati dhe ne duhet të kishim marrë masa, jo mos votohet ne e hedhim në votim s'ka lidhje mund të mos miratohet nuk ka asgjë.

Silvana Aliu . O Erindi mirë që ju morëm e dini vetë ju në çfarë kushtesh ju morëm duke ju marrë 20 herë në telefon edhe...



Erind Tosku . Çfarë lidhje ka numri i telefonit me këtë çështje ...

Silvana Aliu . Do kalojmë ato apo të ngrehemi e të ikim? Sepse ndryshe thatë ndryshe bëtë.

Mukades Gixhari . E keni diskutuar tek mbledhja e komisionit ju?

Erind Tosku . Thashë çfarë ndryshimi do bënte në qoftë se e shtyjme?

Mitat Daja . Atë ndryshimin e gjejmë herë tjetër, mbarojmë këtë punë sot.

Erind Tosku . Do e gjesht ti, ok s'ke përgjigje dmth, kaq.

Silvana Aliu . Jo jo prit mos na flisni me atë mënyrë sepse është hera e dytë që ne po e bëjmë në kushte dhe e dini shumë mirë herën e parë nuk ...edhe sot hajde me të thirrur.

Erind Tosku . Po ti ke qenë Silvana që e ke shtyrë pesë herë, këtë muhabet.

Silvana Aliu . Ç'lidhje ka?

Erind Tosku . Po ka pra.

Alime Hoxha . Një sekondë, ju bëni si të doni tani ky vendim duhet të ishte marrë që në momentin e parë. E lamë në momentin e parë do na sjelli zotëria dokumentacion, e pritëm dy mbledhje nuk na e solli. Mbas atij dokumentacioni do ta shtyjme dhe njëherë, do ta shtyjme dhe dy herë nuk mund ta shtyjme ne sepse ai vendim mund të merret mund të mos merret ne thjeshtë e hedhim në votim.

Mukades Gixhari . Thërrasim dhe kryearin e komisionit të mandateve mbledhjen e radhës që ta diskutojmë. Ta shtyjme për mbledhjen e radhës.

Alime Hoxha . Ne jemi në shkelje, ju bëni si të doni unë këtë kam. Unë jam anëtare e komisionit të mandateve them që jeni në shkelje.

Mitat Daja . Duhet të ishte kryetari i komisionit të mandateve.

Alime Hoxha . Dakord unë mbaj përgjegjësi për pjesën time nuk mbaj për pjesën tjetër.



Mitat Daja . Vazhdojmë me tjerat, vazhdojmë me pikat tjera.

Erind Tosku . Nuk kalon po nuk u hodh në votim.

Mukades Gixhari . Për çfarë ta hedh në votim?

Erind Tosku . Të miratohet do shtyhet apo nuk do shtyhet.

Mukades Gixhari . Jeni dakord që ta shtyjme pikëne dytë e hedhim në votim, kush është...

Silvana Aliu . Nuk ke pse e hedh në votim se na kërkove ta bëjmë mbledhjen në bazë të atyre ... në qoftë se ti nuk e don të respektosh atë që bëre pa filluar mbledhja atëherë ne ikim...

Enver Memolla . Ndaj unë ndërhyra e thashë , duhej të ishte bërë hapja e mbledhjes me ndryshimin e rendit të ditës , ndaj ndërhyra se nuk e dija që është bërë ndryshim i rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Në moment që thirrëm mësues Mitatin që ka problemin e vet madhor në shtëpi ne vendosëm që disa pika të mos të shqyrtohen për këtë...

Enver Memolla . Kryetare ndjesë, rendi i ditës miratohet me ndryshime siç është dhe pa ndryshime ...

Mitat Daja . Zysh që të jesh dhe ti në rregull se po kërkojnë shumë llogari . Hidhe në votim nëse del shumica që do ta votojnë unë po ta them që tani që në këtë moment unë do çohem ... hidhe në votim që të jesh dhe brenda rregullores, nëse ndodh kjo do çohemi.

Mukades Gixhari . Kemi më të rëndësishme pikat tjera.

Alime Hoxha . Ne kushte të tilla njëri tjetrit nuk i vëmë dot. Po deshe po s'deshe. E para punës ...

Silvana Aliu . Nëse do ishte për ndihmat ekonomike, ti nuk ke ardhur për ndihmat ekonomike as mbledhjen e parë as këtë mbledhje kështu që mos thuaj ndihmat ekonomike.

Mitat Daja . Ne nuk i kërkojmë dot llogari asnjërit, vendose vetë kryetare bëje si ta shikosh më të arsyeshme.



Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë tek ndihmat ekonomike dhe kthehemi tek kjo pikë. Vazhdojmë me pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian.

Ledian Hasani . Atëherë në total janë 16 familje përfituese dhe fondi është 67 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Për ndihmën 6%. Pyetje nuk keni e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.12. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1571.Prot datë 17.04.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1571/1.Prot datë 17.04.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me drejtorin i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 22-familje përfituese dhe fondi është 94 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Po ndonjë pyetje ndonjë diskutim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.13. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1527.Prot datë 15.04.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1527/1.Prot datë 15.04.2025.

Mukades Gixhari . Pika 6, Shqyrtim i informacionit, “Mbi rendin dhe sigurinë publike në Bashkinë Rrogozhinë”, të ardhur nga Komisariati i Policisë Kavajë. E kishim këtu zotërinë dhe u



largua pasi kishte probleme tjera urgjente. Kemi pikën 7, Shqyrtim i Raportit, “Mbi masat e marra për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përgatitjen e sezonit turistik në Bashkinë Rrogozhinë”, të ardhur nga drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Do ta shtyjme për mbledhjen e radhës pasi drejtoresha Valmira Troka ka një problem shëndetësor. Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë dhe kjo do shtyhet se nuk e kemi. Jemi tek të ndryshmet...

Silvana Aliu . Ishin prezentë mbledhjen e parë.

Mukades Gixhari . Ishin këtu mbledhjen e parë që nuk u bëmë.

Enver Memolla . Të OSHEE-së Durrës?

Erind Tosku . Kemi 4 muaj që i presim kush ka ardhur asnjëherë nuk ka ardhur OSHEE-ja.

Mukades Gixhari . Kemi kërkesën e bërë nga z. Uran Barameta për ndihmë nga rënia e zjarrit në fermën e tij. z. Ledian?

Ledian Hasani . S’kam informacion për këtë pjesë.

Mukades Gixhari . Atëherë kemi nënkryetarin. Kemi kërkesën nga z. Uran Barameta për ndihmë financiare për shkak të dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në fermën e tij.

Andi Proshka . Është në propozim të këshillit nëse doni.

Mitat Daja . Është propozim apo do bëhet vendim?

Andi Proshka . Do bëhet një projektvendim për mbledhjen e ardhshme, sot është për shqyrtim.

Mukades Gixhari . Jeni dakord që ta kalojmë? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro miratohet. Kemi dhe projektvendimin shtesë të z. Latif Sokoli “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë” Është fjala për z. Latif Sokoli në Gosë, jua kam sjellë në whatsapp.

Ledian Hasani . Atëherë gjendja ekonomike është shumë e dobët.

Mitat Daja . Është përfitues nga fondet e tërmetit ai, me atë lloj shtëpie që kishte ai?



Enver Memolla . Ai është pensionist.

Silvana Aliu . Jo, po pyet për diçka tjetër për tërmetin.

Enver Memolla . Nuk e di për tërmetin.

Mitat Daja . Mendoj që situata ku ishte ai shtëpia aty kishte rënë tërmet 9 ballë jo 6 ballë.

Andi Proshka . Për rastin në fjalë e kemi marrë parasysh kemi çuar grupet e punës tek shtëpia, ta verifikojnë ta studiojnë gjendjen ekonomike financiare vlerësimin e shtëpisë që bëhet nga Instituti i Ndërtimit...

Silvana Aliu . Ndihmën mund ta hapim nuk është ndonjë gjë .

Mukades Gixhari . Jeni dakord ta përfshijmë z. Sokoli. Ta miratojmë?

Alime Hoxha . Është projektvendim?

Mukades Gixhari . Është projektvendim, do ta miratojmë jeni dakord? Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim projektvendimi me shkresë Nr.1612.Prot datë 22.04.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1612/1.Prot datë 22.04.2025.

Vendim nr.14. Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1612.Prot datë 22.04.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1612/1.Prot datë 22.04.2025.

Ledian Hasani . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ledian.Tani doni të kthehemi tek pika 3? Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili?

Mitat Daja . Mirupafshim.



Fatmira Thartori . Mund të jetë dhe diskutim se ne ngrihemi dhe ikim por ka gati 4 muaj kjo gjendje ne duhet të reflektojmë tek kjo pjesë. Në qoftë se Isai ka dokumenta dhe e vërteton këtë pjesën të na e sjelli dhe ne marrim vendimin do rri pao do largohet.

Silvana Aliu . Sepse kur sollëm dokumentat ishte ti e para që kundërshtojë aq shumë.

Fatmira Thartori . Si kundërshtoja, atëherë unë kundërshtova atëherë ti pse po kundërshton tani? Apo ke hallin e zgjedhjeve? Jo, kjo pjesë nuk shtyhet, zyshe nuk shtyhet kjo pjesë më, radhën tjetër ose të merret vendimi ose të vendosim pikat mbi i. Duhet të na sjelli dokumentat i kemi lënë goxha kohë.

Silvana Aliu . I solli.

Fatmira Thartori . Në i ka sjellë dokumentat le ti paraqesë nëse nuk i ka sjellë të merret votimi dhe të ndahen gjërat.

Mukades Gixhari . Z. Enver Memolla nuk e kemi kuorumin po thjeshtë po diskutojmë

Enver Memolla . Mbylle mbledhjen dhe diskutojmë.

Silvana Aliu . A ka qenë grupi juaj që i sollëm dokumentat dhe nuk pranuat? Atëherë çfarë patët? Patët që ju iku Mitati dhe ju mbrapa Mitatit...

Erind Tosku . Po po mbrapa Mitati vazhdojmë e ndjekim mbrapa çfarë bën Mitati ...

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi kuorumin mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 45⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 15 min ; 28 sek.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 11 (njëmbëdhjetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera